



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS

NJOFTIM

PËR SHPALLJEN E POZICIONE VAKANTE PËR STAF AKADEMIK ME KOHË TË PJESSHME NË PROGRAMIN E STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE NË ARKITEKTURË INTERIERI DHE DIZAJN PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027

Kriteret për pranimin e personelit akademik me kohë të pjesshme për programin e studimit Master i Shkencave në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn:

- Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet Master Shkencor (ose ekuivalent me të) në profilet Arkitekturë ose Dizajn, ose në një profil të ngjashëm, me notë mesatare mbi 7.5. Kandidatët preferohen me mesatare mbi 9 në lëndët e disiplinave ku kërkojnë të kontribuojnë, ose të kenë aktivitet të spikatur profesional në fushën përkatëse.
- Preferohen kandidatët që zotërojnë gradën Doktor ose që janë në proces të mbrojtjes së doktoraturës në fushën e Arkitekturës, Dizajnit (ose të ngjashme).
- Preferohen kandidatët që kanë kryer kurse, kualifikime apo që kanë bërë publikime brenda ose jashtë vendit, në fushën e specialitetit përkatës, dhe që zotërojnë të paktën një gjuhë të huaj, të mbrojtur dhe të vërtetuar me dëshmi.
- Preferohen kandidatët me eksperiencë në mësimdhënie, në specialitetin apo fusha ngjashme me disiplinat ku aplikojnë, për të kontribuar si personel akademik me kohë të pjesshme.

Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë kandidatët për personelin akademik me kohë të pjesshme:

- Letër motivimi (specifike për çdo aplikim).
- Dokument identifikimi.
- C. V. e përgjithshme e përqendruar (short-bio, ku evidentohet eksperiencia e lidhur me pozicionin ku aplikohet, jo më e gjatë se një faqe), portfolio e punëve dhe kopje e botimeve/publikimeve.
- Diploma dhe lista e notave (kopje e noteruar).
- Dëshmi e gjuhëve të huaja që zotëron.
- Dy letra reference nga persona me grada, tituj shkencorë apo me përvojë në mësimdhënie në arsimin e lartë.

Vlerësimi i kandidatëve për personelin akademik me kohë të pjesshme:

Komisioni i vlerësimit përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë: drejtuesi i Departamentit, drejtuesi i lëndës, mësimdhënësi i lëndës (apo të lëndëve të ngjashme).



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS

- Vlerësimi i përmbajtjes së dosjes së dorëzuar nga konkurrenti: 60%.
- Vlerësimi i konkurrentit përmes një interviste në Komisionin e Vlerësimit: 40%.

Në përfundim të procesit, Komisioni liston kandidatët në rend zbritës dhe kjo listë shërben për plotësimin e vendeve vakante për mësimdhënie në lëndën përkatëse.

Lista e lëndëve që kanë nevojë për personel akademik me kohë të pjesshme:

Kursi	Lënda
VITI I	Studio ID4
	Kulturë Digjitale
	Kompozim në Dizajnin Grafik
	Webdesign
	Marketing dhe Brandim
	Studio ID5
	Human Centered Design
	Histori dhe Antropologji e Dizajnit
	Projektim i Qëndrueshëm
	Mjedis dhe Impiantistikë 2

*Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatet do të jetë deri në datë **28.09.2026** pranë Departamentit të Arkitekturës.*

*Intervistat do të zhvillohen në datën **29.09.2026***